


17 korrik 2012, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Dëshmitë e degradimit urban të Prizrenit

EC Ma Ndryshe edhe gjatë muajit korrik ka vazhduar me monitorimin e punës së ekzekutivit komunal të komunës së Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në fokus të monitorimit ka qenë sektori i urbanizmit dhe ndërtimet në Qendrën Historike të Prizrenit. Vetëm në gjashtë muajt e vitit 2012 nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren janë lëshuar 62 pëlqime për ndërtim apo ndërhyrje në Qendrën Historike të Prizrenit. Shqetësues mbetet fakti që në një numër të konsiderueshëm ndërtimesh nuk respektohen projektet origjinale dhe leja e punës së lëshuar nga autoritetet komunale. Ky Institut edhe pse nuk e ka për obligim të procedojë kërkesa pranë Drejtorisë së Inspekcioneve, në tri vitet e fundit ka dërguar më se 25 kërkesa për ndërprerjen e punimeve apo edhe rrënimin e tyre për mos respektim të projektit në pajtim me pëlqimin e lëshuar nga Instituti dhe në pajtim me parimet e trashëgimisë kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit.

Deri më tani janë identifikuar disa punime që janë kryer në kundërshtim me kriteret e ndërtimit dhe ndërhyrjes për Qendrën Historike të Prizrenit, si dhe në shpërputhje me lejen e punës së lëshuar nga autoritetet komunale. Konkretisht, monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë konstatuar se shkeljet më flagrante në këtë zonë janë punimet në: Hotel Therandë, kafe "Hollywood", ish shtëpia e Mallrave në Shatërvan, shtrimi i kubëzave nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në sheshin Shatërvan (e realizuar pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në



Prizren), ndërtimi i vrazhdë pranë shtëpisë së Shuaip Spahisë, ndërtimi i vrazhdë pranë objektit të IMMK-së, ndërtimi i disa hoteleve, etj. Shkeljet e kriterëve dhe lejeve të ndërtimit dhe ndërhyrjes në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me tejkalimin e bazës dhe etazhitetit të ndërtimit. Të gjitha këto raste të përmendura janë dokumentuar edhe me fotografi përcjellëse, të cilat u janë bashkëngjitur kësaj komunikate.

Nga të gjeturat e monitorimit dhe vëzhgimeve në terren, të ndërmarrë nga monitorues dhe aktivistë të EC Ma Ndryshes, vërehet qartë se pohimet e

zyrtarëve komunalë se nuk ka tejkalime dhe mosrespektim të lejeve dhe kriterëve të ndërtimit në Qendrën Historike të Prizrenit, nuk qëndrojnë. Po ashtu edhe në shkresën zyrtare me nr. 04-353 të datës 4 mars 2012 nga Drejtoria e Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit thuhet se "ndërtimet e fundit të cilat janë duke u zhvilluar në brendi të zonës së konservimit janë në kundërshtim me lejen e ndërtimit". Kjo shkresë zyrtare i është bashkëngjitur kësaj komunikate.

EC Ma Ndryshe kërkon që qeveria lokale e Prizrenit, urgjentisht të ndërmarrë veprime të nevojshme në drejtim të normalizimit të gjendjes në Qendrën Historike të Prizrenit. Në të kundërtën, qeveria lokale do të shndërrojë Qendrën Historike të Prizrenit në gërmadha betonesh dhe ndërtime të tipit “modern”, që as për së afërmi nuk përkojnë me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, të miratuar nga vetë Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2008. Në rradhë të parë, kërkojmë që Drejtoria Komunale e Urbanizmit të veprojë në pajtueshmëri të plotë me mendimin e lëshuar nga Instituti i Monumenteve, ndërsa nga Drejtoria e Inspektorateve që të monitorojë me rigjeditet maksimal përmbajtjen me kriteret e parapara në lejen e ndërtimit. Në rast të identifikimit të shkeljeve gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve, ekzekutivi i komunës (me theks të veçantë kryetari i komunës) duhet të ndërmarrin veprime konkrete parandaluese, ndërsa në rast të vazhdimit të punimit, edhe veprime ndëshkuese ndaj personave që nuk i respektojnë kriteret e ndërtimit. Poashtu, i apelojmë edhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren që të jetë më rigjide në dhënien e pëlqimeve për punime në Qendrën Historike të Prizrenit, si dhe të jetë më aktive në monitorimin e ekzekutimit të punimeve në këtë Qendër, duke e përdorur autoritetin qendror, respektivisht Ministrinë e Kulturës (pjesë e së cilës është) dhe qeverinë e Kosovës për veprime parandaluese dhe ndëshkuese ndaj komunës dhe shkelësve të tjerë të kriteve dhe lejeve të ndërtimit dhe standardeve të trashëgimisë kulturore në Prizren.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit korrik përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 522 199 & +386 49 116 448

**Projekti “Transparenca on-line e komunës së Prizrenit” mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur**

**SOROS**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo